

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTIME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-26-5195-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi, Dezinsektimi, dhe Deratizimi i objekteve institucionale në Komunën e Shtimës Kontratë kornizë 24 muaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

VLERA SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

12 Qershori, Shtime

(Adresa)

Shtime

(Vendi)

72000

(Kodi postar)

+38344228069

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Dr. Diellon Salihaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

vlera.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

17.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

-

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

B05 Njoftim per Kontrat: 30.06.2026

- Me daten 06.07.2026 permes e-prokurimit kemi dorzuar KERKESEN PER RISHQYRTIM NE AUTORITETIN KONTRAKTUES.
- Me daten 09.07.2026 Autoriteti Kontraktues na njofton qe ka aprovuar (pjeserisht) kerkesen tone per rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 51 – Kriteret e Përzgjedhjes

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 64 – Dëshmitë e kërkesave

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, **ne, Operatori Ekonomik VLERA SH.P.K.**, paraqesim këtë **Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Shtimes, të datës 09.07.2026**, me të cilin është aprovuar vetëm pjesërisht Kërkesa jonë për Rishqyrtim, e paraqitur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i objekteve institucionale në Komunën e Shtimes – Kontratë kornizë 24 muaj"**, me numër të prokurimit **617-26-5195-2-2-1**

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit për aktivitetin e lartcekur, ndërsa ne, pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, kemi konstatuar se disa nga kriteret e kualifikimit dhe kërkesat teknike nuk janë në përputhje me dispozitat e

Ligjit për Prokurimin Publik, pasi janë kufizuese, joproporcionale dhe cenojnë parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, më **06.07.2026**, kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim, duke kërkuar korrigjimin e pikave të kontestuara të Dosjes së Tenderit.

Me Vendimin e datës **09.07.2026**, Autoriteti Kontraktues ka aprovuar vetëm pjesërisht Kërkesën tonë për Rishqyrtim, ndërsa pjesën tjetër të pretendimeve tona e ka refuzuar si të pabazuar.

Ne konsiderojmë se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të plotë, objektiv dhe të bazuar në ligj për refuzimin e pretendimeve tona. Përkundrazi, ai ka lënë në fuqi kërkesa të Dosjes së Tenderit që vazhdojnë të jenë joproporcionale, kufizuese dhe diskriminuese, pa dëshmuar se ato janë të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Për këto arsye, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë ankesë, duke kërkuar që, pas shqyrtimit të saj, **ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues të korrigjojë Dosjen e Tenderit**, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.

PRETENDIMET ANKIMORE

Me qëllim të paraqitjes së plotë të bazës faktike dhe juridike të kësaj ankese, më poshtë paraqesim secilin prej pretendimeve tona ankimore, ashtu siç janë ngritur fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim, së bashku me përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues në Vendimin për Rishqyrtim.

Pas paraqitjes së secilit pretendim dhe përgjigjes përkatëse të Autoritetit Kontraktues, ne do të paraqesim analizën dhe arsyetimin tonë juridik, duke argumentuar pse konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, parimet themelore të prokurimit publik dhe praktikën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimi nr. 5 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Lidhur me kërkesën nr. 5 të Dosjes së Tenderit,

Kërkesa 5. OE duhet të ketë një ekspert për siguri dhe shëndet në punë me përvojë min 5 vite.

Dëshmia 5.Çertifikaten si ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS apo ndonjë institucion i çertifikuar nga MPMS , CV e nënshkruar, kontrata e punës apo parakontrata në emer të projektit.

Arsyetim Kërkesa nr. 5 është e pajustificuar dhe joproporcionale, pasi kërkohet që operatori ekonomik të ketë një ekspert për siguri dhe shëndet në punë me minimum 5 vite përvojë. Për realizimin e shërbimeve DDD, përgjegjësitë organizative dhe mbikëqyrëse mbulohen nga stafi profesional i kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe nga menaxheri i kontratës, i cili udhëheq dhe koordinon realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar nevojën për një ekspert të veçantë të sigurisë dhe shëndetit në punë si kriter kualifikimi, prandaj kjo kërkesë paraqet një kriter shtesë të panevojshëm që rëndon pa arsye kriteret e kualifikimit dhe kufizon konkurrencën, në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 3 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik. **Kërkohet që Kërkesa nr. 5 të hiqet nga Dosja e Tenderit, pasi përgjegjësitë për organizimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës mbulohen nga stafi profesional dhe menaxheri i kontratës, duke e bërë këtë kërkesë të panevojshme dhe joproporcionale.**

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues:

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (5)

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se Autoriteti Kontraktues nuk e ka arsyetuar kërkesën për angazhimin e një Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se ky pretendim është i pjesshëm i bazuar me arsyetimin si ne vijim:

Objekti i kësaj kontrate përfshin shërbime të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit, të cilat përfshijnë përdorimin e produkteve biocide dhe substancave kimike, si dhe ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve profesionale gjatë kryerjes së punëve në objekte publike dhe institucionale. Për këtë arsye, zbatimi i masave për sigurinë dhe shëndetin në punë është i domosdoshëm.

Në përputhje me legjislacionin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, punëdhënësi ka obligim të ndërmarrë masa për parandalimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e punëmarrësve. Njëkohësisht, Ligji për Prokurimin Publik i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të përcaktojë kritere të kualifikimit që janë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës, dhe është nivel profesional dhe ligjor që kompania të punësoj apo të angazhoj ekspert të till, sidomos kur kemi të bëjmë me rrezik për shëndetin e punëtorëve në punë me përdorimin e produkteve biocide.

Për këtë arsye, kërkesa për disponueshmërinë e një Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë me përvojë min 5 vite, largohet dhe zëvendësohet " Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë me përvojë min 2 vite" pra eksperti në fjalë është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik posedon kapacitetet profesionale për menaxhimin e rreziqeve dhe zbatimin e standardeve të sigurisë gjatë ekzekutimit të kontratës. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, nuk favorizon asnjë operator ekonomik dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë ofertuesit.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale dhe nuk bie në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 3 apo nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për pasojë, ky pretendim pranohet si pjesërisht i bazuar.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMI NR. 5

Ne nuk pajtohem me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e këtij pretendimi, pasi ai nuk është i mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe nuk demonstroi se kërkesa për një ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me minimum pesë (5) vite përvojë është objektivist e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktues arsyeton se objekti i kontratës përfshin përdorimin e produkteve biocide dhe, për këtë arsye, ekziston nevoja për zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Ne nuk e kontestojmë faktin se gjatë realizimit të shërbimeve DDD duhet të respektohen të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë sigurinë dhe shëndetin në punë.

Megjithatë, çështja që kemi ngritur nuk ka të bëjë me zbatimin e këtyre masave, por me faktin se Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar pse një ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me minimum pesë (5) vite përvojë duhet të jetë kriter paraprak i kualifikimit për këtë aktivitet të prokurimit.

Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues kufizohet në përshkrimin e përgjithshëm të rreziqeve që mund të paraqiten gjatë realizimit të kontratës dhe në detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë. Mirëpo, ai nuk ka paraqitur asnjë analizë konkrete që të dëshmojë se vetëm një operator ekonomik që disponon një ekspert të tillë me pesë (5) vite përvojë është në gjendje ta realizojë këtë kontratë. Po ashtu, nuk është arsyetuar pse stafi profesional i kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe menaxheri i kontratës nuk janë të mjaftueshëm për organizimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës.

Sipas nenit 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë dëshmi lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale vetëm në masën që ato janë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Gjithashtu, neni 69 kërkon që kriteret e aftësisë teknike dhe profesionale të jenë objektive, të arsyeshme dhe të nevojshme për realizimin e kontratës.

Po ashtu, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të mos vendosë kërkesa që kufizojnë ose eliminojnë konkurrencën pa një arsyetim objektiv. Në veçanti, paragrafi 3 i këtij neni ndalon vendosjen e kërkesave ose kriterëve të përzgjedhjes që favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë, ndërsa paragrafi 6 obligon Autoritetin Kontraktues të eliminojë kriteret dhe kërkesat diskriminuese dhe të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të mos vendosë kërkesa që kufizojnë ose eliminojnë konkurrencën pa një arsyetim objektiv. Në veçanti, paragrafi 3 i këtij neni ndalon vendosjen e kërkesave ose kriterëve të përzgjedhjes që favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë, ndërsa paragrafi 6 obligon Autoritetin Kontraktues të eliminojë kriteret dhe kërkesat diskriminuese dhe të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka provuar se kërkesa për një ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me minimum pesë (5) vite përvojë është e domosdoshme për realizimin e kontratës. Përkundrazi, ai vetëm ka përshkruar obligimet e përgjithshme që çdo punëdhënës i ka sipas legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Këto obligime ekzistojnë për çdo operator ekonomik pavarësisht nëse një kërkesë e tillë është përfshirë ose jo në Dosjen e Tenderit dhe nuk mund të përdoren si bazë për vendosjen e një kriteri shtesë të kualifikimit pa një arsyetim të veçantë.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues pranon se kërkesa fillestare nuk ishte e arsyeshme, pasi me vendimin për rishqyrtim e ka ndryshuar atë duke e ulur përvojën e kërkuar nga pesë (5) vite në dy (2) vite. Ky veprim dëshmon se kriteri fillestar nuk ishte i domosdoshëm dhe nuk ishte i mbështetur në një analizë objektive. Megjithatë, edhe pas këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar pse kërkohet fare një ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë si kriter kualifikimi, kur realizimi i kontratës mbikëqyret nga stafi profesional dhe menaxheri i kontratës, ndërsa respektimi i legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë është detyrim ligjor i çdo punëdhënësi.

Për këto arsye, konsiderojmë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmbush standardin e arsyetimit të kërkuar nga Ligji për Prokurimin Publik dhe nuk dëshmon se kjo kërkesë është e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Si rrjedhojë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta pranojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues ta largojë këtë kërkesë nga Dosja e Tenderit.

Pretendimi nr. 7 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Kërkesa 7. OE duhet të ketë një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog , me përvojë pune, minimumi 5 vite pas diplomimit.

Dëshmia 7. Diplma kopje , dokument dëshmi mbi përvojen e punës CV e nënëshkruar nga vet personi , kontrata e punës ose parakontrata

Arsyetim Kërkesa nr. 7 është diskriminuese dhe kufizuese për konkurrencën, pasi kërkon që operatori ekonomik të ketë vetëm **një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog** me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, duke përjashtuar pa bazë ligjore profilin profesional të **Agronomit**. Sipas kushteve zyrtare për pajisje me **Leje të përkohshme për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim (DDD)**, të nxjerra në zbatim të **Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve**, si dokumentacion i nevojshëm kërkohet **diploma për përgatitje profesionale nga Fakulteti i Bujqësisë, Agronom, ose Dipolme Universitare te Veterinarisë, Epidemiologjisë ose Ekologjisë**. Po ashtu, në aplikim kërkohet edhe **emri dhe mbiemri i agronomit**. Rrjedhimisht, vetë rregullat zyrtare të licencimit e njohin **Agronomin** si profil të pranueshëm për ushtrimin e veprimtarisë DDD, ndërsa në kërkesën e Autoritetit Kontraktues ky profil është përjashtuar pa asnjë arsyetim apo bazë ligjore. Ky kufizim bie ndesh me **nenin 7 dhe nenin 51 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi kufizon konkurrencën dhe trajton në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë që disponojnë personel me kualifikim të pranueshëm sipas rregullave të licencimit. **Për këtë arsye, kerkojme nga Autoritetin Kontraktues që ta aprovojë këtë kërkesë për rishqyrtim dhe të bëjë ndryshimin e Kërkesës nr. 7 të Dosjes së Tenderit**, duke përfshirë edhe profilin profesional të **Agronomit**, në mënyrë që kërkesa të jetë në përputhje me kushtet zyrtare të licencimit për kryerjen e shërbimeve DDD, të mos kufizojë konkurrencën dhe të respektojë parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues:

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (7)

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se kërkesa për një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog me përvojë pune minimale pesë (5) vjeçare është në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim të pabazuar.

Autoriteti Kontraktues thekson se kërkesa në fjalë nuk është vendosur për qëllim kufizimin e konkurrencës, por për të siguruar që operatori ekonomik të disponojë kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Legjislacioni për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit përcakton kushtet minimale për pajisjen me licencë. Megjithatë, plotësimi i kushteve minimale për licencim nuk e kufizon të drejtën e Autoritetit Kontraktues që, në përputhje me nenin 51 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë kapacitete profesionale shtesë, për atë kohë sa ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe janë proporcionale.

Objekti i kësaj kontrate nuk konsiston vetëm në posedimin e licencës DDD, por në ofrimin e shërbimeve profesionale në ambiente ku kërkohet vlerësim i rreziqeve biologjike, planifikim i masave parandaluese, monitorim i efekteve të trajtimeve dhe mbrojtje e shëndetit publik. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se profili profesional i Epidemiologut, Ekologut ose Biologut është drejtpërdrejt i lidhur me natyrën e shërbimeve që do të realizohen.

Gjithashtu, kërkesa nuk është kufizuese, pasi Autoriteti Kontraktues ka pranuar tre profile të ndryshme profesionale (Epidemiolog, Ekolog ose Biolog), duke zgjeruar mundësinë e

pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe duke mos e kufizuar konkurrencën në një profesion të vetëm.

Përvoja minimale pesë (5) vjeçare është kërkuar për të garantuar se personi përgjegjës posedon përvojën e nevojshme praktike për menaxhimin e shërbimeve DDD, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e shëndetit publik dhe kërkojnë njohuri të avancuara profesionale.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa është objektive, proporcionale, e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe në përputhje me nenin 7, nenin 51 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik. Pretendimi i operatorit ekonomik refuzohet si i pabazuar.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMI NR. 7

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e këtij pretendimi, pasi ai nuk mbështetet në bazë ligjore dhe nuk jep asnjë arsyetim objektiv pse profili profesional i **Agronomit** është përjashtuar nga kjo kërkesë, ndonëse është një nga profilet profesionale të njohura për ushtrimin e veprimtarisë së Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit (DDD).

Autoriteti Kontraktues pretendon se kërkesa nuk është kufizuese, pasi janë pranuar tre profile profesionale, përkatësisht Epidemiolog, Ekolog ose Biolog. Megjithatë, ky arsyetim nuk i përgjigjet pretendimit tonë. Ne nuk kemi kundërshtuar përfshirjen e këtyre profileve profesionale, por kemi kërkuar që edhe **Agronomi** të trajtohet në mënyrë të barabartë, pasi është profil profesional i njohur nga legjislacioni sektorial për ushtrimin e veprimtarisë DDD.

Në përgjigjen e tij, Autoriteti Kontraktues pretendon se legjislacioni për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit përcakton vetëm kushtet minimale për pajisje me licencë dhe se, në bazë të nenit 51 dhe nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, ai ka të drejtë të kërkojë kapacitete profesionale shtesë. Ne nuk e kontestojmë të drejtën e Autoritetit Kontraktues për të vendosur kritere të aftësisë profesionale, mirëpo kjo e drejtë nuk është absolute. Çdo kriter duhet të jetë i

arsyetuar, proporcional, objektiv dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pa kufizuar konkurrencën në mënyrë të pajustificuar.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë argument teknik apo ligjor që të dëshmojë se një **Agronom**, ndonëse është profil profesional i njohur nga legjislacioni përkatës për ushtrimin e veprimtarisë DDD, nuk është i aftë të realizojë apo të mbikëqyrë këto shërbime. Përkundrazi, ai është mjaftuar vetëm me konstatimin se kërkesa është proporcionale, pa shpjeguar pse një operator ekonomik që disponon këtë profil profesional nuk duhet të lejohet të konkurrojë në këtë aktivitet të prokurimit.

Për më tepër, kushtet zyrtare për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), të nxjerra në zbatim të legjislacionit përkatës, e njohin **Agronomin** si një nga profilet profesionale të pranueshme për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Edhe ne, si Operator Ekonomik **VLERA SH.P.K.**, gjatë procedurës së pajisjes me licencë DDD kemi paraqitur diplomën e Agronomit si pjesë të dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kompetent. Kjo dëshmon se vetë sistemi i licencimit e njeh Agronomin si profil profesional të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Për rrjedhojë, përjashtimi i këtij profili nga kërkesat e Dosjes së Tenderit, pa asnjë arsyetim teknik apo ligjor, është i pajustificuar dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim objektiv dhe të bazuar në fakte se përse ka kufizuar profilet profesionale vetëm në **Epidemiolog, Ekolog ose Biolog**, duke përjashtuar profilin e **Agronomit**, i cili njihet nga legjislacioni përkatës si profil profesional i pranueshëm për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Për më tepër, profilet profesionale të kërkuara në Dosjen e Tenderit janë në numër të kufizuar në rajonin tonë, ndërsa përjashtimi i Agronomit zvogëlon ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që mund ta përmbushin këtë kriter. Si pasojë, ky kriter ka efekt kufizues mbi konkurrencën dhe krijon rrethana që mund të favorizojnë operatorë ekonomikë të caktuar, duke ngushtuar pjesëmarrjen në këtë procedurë të prokurimit.

Sipas **nenit 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, ndërsa i ndalohet të vendosë kërkesa apo kritere përzgjedhëse që kufizojnë konkurrencën ose favorizojnë operatorë të caktuar pa një arsyetim objektiv. Po ashtu, **neni 51** dhe **neni 69** kërkojnë që kriteret e aftësisë profesionale të jenë proporcionale, objektive dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë se përjashtimi i Agronomit përmbush këto standarde ligjore. Përkundrazi, ai ka mbajtur në fuqi një kriter kufizues pa paraqitur asnjë analizë profesionale apo bazë ligjore që do të justifikonte përjashtimin e një profili profesional të njohur nga legjislacioni sektorial.

Për këto arsye, konsiderojmë se përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk e rrëzon pretendimin tonë dhe nuk përmbush standardin e arsyetimit të kërkuar nga Ligji për Prokurimin Publik. Përkundrazi, ajo konfirmon se përjashtimi i Agronomit është bërë pa analizë objektive dhe pa bazë ligjore, duke kufizuar pa arsye konkurrencën dhe duke trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë që disponojnë personel profesional të njohur nga legjislacioni për licencimin e veprimtarisë DDD.

Për më tepër, **Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve**, si dhe kushtet zyrtare për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD, e njohin **Agronomin** si profil profesional të pranueshëm për kryerjen e këtyre shërbimeve. Prandaj, përjashtimi i këtij

profili nga kriteret e Dosjes së Tenderit, pa ndonjë arsyetim teknik apo bazë ligjore, është i pajustificuar dhe në kundërshtim me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë të përcaktuara në **nenin 7**, si dhe me **nenet 51 dhe 69** të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që në Kërkesën nr. 7 të Dosjes së Tenderit të përfshijë edhe profilin profesional të Agronomit, në mënyrë që kriteri të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mos kufizojë konkurrencën dhe të respektojë parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Pretendimi nr. 8 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Lidhur me kërkesën nr. 8 të Dosjes së Tenderit,

Kërkesa 8. OE duhet të ketë menaxher të kontratës një Biolog me përvojë pune min. 3 vite në fushen e DDD-së.

Dëshmia 8. Diplpma kopje , dokument dëshmi mbi përvojen e punës CV e nënëshkruar nga vet personi, vendimi per caktim të menaxherit të kontratës si dhe kontrata e punës ose parakontrata

Arsyetim: Kërkesa nr. 8 është diskriminuese dhe kufizuese, pasi kërkon që menaxheri i kontratës të jetë vetëm **Biolog** me minimum 3 (tre) vite përvojë pune në fushën e DDD-së. Një kriter i tillë nuk është proporcional me objektin e kontratës dhe kufizon pa bazë ligjore konkurrencën. Për më tepër, në praktikën e prokurimit publik për shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), **në dosjet e tenderëve nuk kërkohet ekskluzivisht profili i Biologut**, por u jepet mundësia edhe profileve të tjera profesionale, si **Agronomi, Veterinari dhe Epidemiologu**, të ushtrojnë funksionin e menaxherit të kontratës, duke qenë se këto profile janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë DDD dhe pranohen edhe sipas kushteve të licencimit. Kufizimi vetëm në profilin e Biologut nuk mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe bie ndesh me **nenin 7 dhe nenin 51 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi kufizon konkurrencën dhe trajton në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë. **Kërkohet ndryshimi i Kërkesës nr. 8 të Dosjes së Tenderit, duke mundësuar që funksionin e menaxherit të kontratës ta ushtrojë edhe Agronomi, Veterinari dhe Epidemiologu, e jo të kufizohet vetëm në profilin e Biologut.**

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues:

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (8)

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për kriterin që Menaxheri i Kontratës duhet të jetë Biolog me përvojë minimale pesë (3) vjeçare në fushën e DDD, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura dhe vlerëson si pjesërisht të bazuar dhe konkuodon se:

Autoriteti Kontraktues konsideron se qëllimi i këtij kriteri ka qenë sigurimi i një niveli të lartë profesional në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës, duke pasur parasysh natyrën e shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e shëndetit publik dhe kontrollin e rreziqeve biologjike.

Megjithatë, pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik dhe me qëllim të garantimit të konkurrencës sa më të gjerë, pa cenuar nevojat funksionale të kontratës, Autoriteti Kontraktues vlerëson se objektivi i kriterit mund të arrihet edhe duke pranuar profile të tjera profesionale ekuivalente, të cilat legjislacioni sektorial i njeh si të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë DDD.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues vendos ta pranojë pjesërisht kërkesën për rishqyrtim për këtë pretendim ankimor vetëm në pjesën që ka të bëjë me profilin profesional të Menaxherit të Kontratës.

Rrjedhimisht, autoriteti e pranon si pjesërisht të bazuar pretendimin dhe kriteri do të riformulohet si më poshtë:

Menaxheri i Kontratës duhet të jetë Biolog ose Epidemiolog, me përvojë profesionale minimale pesë (3) vjeçare në fushën e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMI NR. 8

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin pjesërisht të këtij pretendimi, pasi edhe pse ka pranuar se kriteri fillestar ishte i pajustificuar dhe ka zgjeruar profilin profesional duke përfshirë edhe Epidemiologun krahas Biologut, ai ka vazhduar të përjashtojë pa asnjë arsyetim objektiv profilet e **Agronomit** dhe **Veterinarit**, të cilat janë po ashtu profile profesionale të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit (DDD).

Nga vetë përgjigjja e Autoritetit Kontraktues rezulton se ai ka pranuar se objektivi i kriterit – sigurimi i një niveli të lartë profesional në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës – **mund të arrihet edhe duke pranuar profile të tjera profesionale ekuivalente**, të cilat legjislacioni sektorial i njeh si të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Megjithatë, përkundër këtij konstatimi, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse ka pranuar vetëm profilin e Epidemiologut, ndërsa ka vazhduar të përjashtojë Agronomin dhe Veterinarin.

Ky veprim është kontradiktor, pasi vetë Autoriteti Kontraktues pranon se kriteri nuk duhet të kufizohet vetëm në një profil profesional, por pa asnjë analizë teknike apo ligjore vendos të kufizohet vetëm në dy profile, duke mos shpjeguar pse profilet e tjera profesionale të njohura nga legjislacioni sektorial nuk konsiderohen të përshtatshme për të ushtruar funksionin e menaxherit të kontratës.

Për më tepër, **Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve**, si dhe kushtet zyrtare për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD, njohin **Agronomin** si profil

profesional të pranueshëm për kryerjen e këtyre shërbimeve. Në të njëjtën mënyrë, edhe profili i **Veterinarit** është i lidhur drejtpërdrejt me kontrollin e organizmave të dëmshëm, mbrojtjen e shëndetit publik dhe zbatimin e masave sanitare. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë objektive apo ligjore që këto profile të përjashtohen nga ushtrimi i funksionit të menaxherit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë profesionale që të dëshmojë se vetëm Biologu ose Epidemiologu janë të aftë të menaxhojnë kontratën, ndërsa Agronomi dhe Veterinari nuk i plotësojnë këto kompetenca. Një kufizim i tillë nuk mbështetet në natyrën e kontratës, nuk është proporcional me objektin e prokurimit dhe për rrjedhojë kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

Për më tepër, profilet profesionale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues janë në numër të kufizuar në rajonin tonë. Përjashtimi i Agronomit dhe Veterinarit zvogëlon ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që mund të përmbushin këtë kriter dhe krijon rrethana që mund të favorizojnë operatorë ekonomikë të caktuar, duke kufizuar konkurrencën pa një arsyetim objektiv.

Sipas **nenit 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese, ndërsa **nenet 51 dhe 69** kërkojnë që kriteret e aftësisë profesionale të jenë proporcionale, objektive dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë se përjashtimi i profileve të Agronomit dhe Veterinarit përmbush këto standarde ligjore.

Prandaj, konsiderojmë se përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk e rrëzon pretendimin tonë. Përkundrazi, ajo konfirmon se kriteri fillestar ka qenë i pajustificuar, pasi vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar ta ndryshojë atë. Megjithatë, ndryshimi i bërë mbetet i paplotë dhe vazhdon të kufizojë konkurrencën në mënyrë të pajustificuar, duke përjashtuar profile profesionale të njohura nga legjislacioni sektorial dhe të afta për ushtrimin e funksionit të menaxherit të kontratës.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që Kërkesën nr. 8 të Dosjes së Tenderit ta riformulojë në mënyrë që funksionin e menaxherit të kontratës të mund ta ushtrojnë edhe profilet profesionale të Agronomit dhe Veterinarit, krahas Biologut dhe Epidemiologut, duke siguruar respektimin e parimeve të barazisë, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Pretendimi nr. 9 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Lidhur me kërkesën nr. 9 ,pika a) të Dosjes së Tenderit,

Kërkesa 9. OE duhet të dëshmojë se ka staf profesional për realizimin e shërbimeve ; a) Një teknik sanitar b) Katër teknik në shërbimit të DDD-së

Dëshmia 9. Kopja e Licences për teknikun sanitar, valide , ndërsa për stafin në përgjithësi, kontratat e punës ose parakontrata për projektin në fjalë si dhe çertifikatat.

Arsyetim : Kërkesa nr. 9, pika a), me të cilën kërkohet një teknik sanitar, është e tepërt dhe joproporcionale, pasi kjo përgjegjësi mbulohet nga menaxheri i kontratës i cili është përgjegjës për organizimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e realizimit të shërbimeve DDD. Prandaj, kjo kërkesë vetëm rëndon kriteret e kualifikimit dhe kufizon pa nevojë konkurrencën, në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 3 të LPP-së. **Kërkohet largimi i Kërkesës nr. 9, pika a), pasi funksioni i teknikut sanitar mbulohet nga menaxheri i kontratës i kërkuar**

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (9)

Autoriteti Kontraktues e refuzon pretendimin e operatorit ekonomik si të pabazuar me arsyetimin si ne vijim :

Kërkesa për një (1) teknik sanitar është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është plotësisht në përputhje me nenin 51 të LPP-së, pasi përfaqëson një kapacitet minimal profesional të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit.

Pretendimi se tekniku sanitar mund të zëvendësohet nga menaxheri i kontratës nuk qëndron, pasi këto janë funksione me përgjegjësi të ndryshme. Menaxheri i kontratës ka rol koordinues dhe administrativ, ndërsa tekniku sanitar është personeli profesional përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen teknike të shërbimeve DDD, në përputhje me standardet profesionale dhe masat sanitare.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë që dëshmon se kjo kërkesë është joproporcionale; përkundrazi, ka paraqitur vetëm një interpretim subjektiv. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kriteri është i arsyeshëm, proporcional dhe i domosdoshëm për realizimin cilësor të kontratës, Andaj mbështetur nga elaborimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor refuzohet i pa bazuar.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMIN NR. 9

Ne nuk pajtohem me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues, pasi ai është mjaftuar vetëm me konstatimin se tekniku sanitar është i nevojshëm për realizimin e kontratës, pa dhënë asnjë analizë objektive apo bazë ligjore që dëshmon domosdoshmërinë e këtij kriteri si kërkesë e veçantë e kualifikimit.

Autoriteti Kontraktues pretendon se menaxheri i kontratës dhe tekniku sanitar kanë funksione të ndryshme, mirëpo nuk ka argumentuar pse këto detyra nuk mund të mbulohen nga menaxheri i kontratës, i cili është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të shërbimeve DDD. Për më tepër, në Dosjen e Tenderit janë kërkuar edhe **katër teknikë të DDD-së**, të cilët do të realizojnë punët operative në terren.

Si rrjedhojë, shihet qartë se Autoriteti Kontraktues ka ngarkuar pa nevojë kërkesat për staf profesional, duke kërkuar edhe një teknik sanitar shtesë, pa dëshmuar se kjo është e domosdoshme për realizimin e kontratës. Një kriter i tillë është joproporcional dhe kufizon pa arsye konkurrencën, në kundërshtim me **nenin 51 paragrafi 3** dhe **nenin 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilët kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë proporcionale dhe të mos kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues të largojë kërkesën për teknik sanitar nga Kërkesa nr. 9, pika a), pasi nuk është dëshmuar se kjo kërkesë është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Pretendimi nr. 11 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Lidhur me kërkesën nr.11 të Dosjes së Tenderit,

Kërkesa 11. Deklaratë se produktet e ofruara janë ekologjike.

Dëshmia 11. Deklatata origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE

Arsyetim Kërkesa nr. 11, në parim, është e pranueshme, mirëpo dëshmia e kërkuar nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar se produktet e ofruara janë ekologjike. Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik nuk përbën provë objektive dhe nuk garanton saktësinë e deklaramit. Për të siguruar transparencë, trajtim të barabartë dhe mundësi verifikimi, kërkohet që, përveç deklaratës së operatorit ekonomik, të kërkohet edhe **Leja për importin e biocideve, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**, si dokument zyrtar që mundëson identifikimin dhe verifikimin e produkteve/preparateve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës.

Kërkohet që te Kërkesa nr. 11, përveç deklaratës së operatorit ekonomik, të kërkohet edhe Leja për importin e biocideve, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dokument zyrtar që mundëson verifikimin e produkteve/preparateve të ofruara.

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues Pretendimi/kerkesa (11):

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (11)

Autoriteti Kontraktues e refuzon pretendimin e operatorit ekonomik si të pabazuar. Kërkesa për paraqitjen e një deklarate se produktet që do të përdoren janë ekologjike është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit gjatë realizimit të shërbimeve DDD.

Pretendimi se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë leje importi për produkte biocide është i pasaktë dhe nuk lidhet me objektin e procedurës së prokurimit. Kjo kontratë nuk ka për objekt furnizimin apo importimin e produkteve biocide, por ofrimin e shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit. Për rrjedhojë, posedimi i një lejeje importi nuk përbën kapacitet të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Operatori ekonomik mund të sigurojë produktet nga distributorë ose furnizues të autorizuar që i tregtojnë ligjërisht produktet biocide në Republikën e Kosovës, pa qenë vetë importues. Prandaj, kërkesa për leje importi do të ishte jo relevante dhe do të kufizonte pa arsye konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët që importojnë produkte, në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se deklarata për përdorimin e produkteve ekologjike është kërkesë e arsyeshme, proporcionale dhe e mjaftueshme për të garantuar cilësinë e shërbimeve, pasi që për këtë Operatori Ekonomikë jep deklarim nën Betim se produktet që do të përdorë janë ekologjike dhe rrjedhimisht një deklaratë e tillë do të përdoret OE edhe në vlerësim edhe në realizim të shërbimeve. Andaj mbështetur nga elaborimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor refuzohet i pa bazuar.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMIN NR. 11

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues, pasi ai nuk i është përgjigjur thelbit të pretendimit tonë. Ne nuk kemi kërkuar largimin e kërkesës që produktet e përdorura të jenë ekologjike, por kemi kërkuar që kjo kërkesë të mbështetet me **dokumentacion zyrtar dhe të verifikueshëm**, e jo vetëm me një deklaratë të operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktues arsyeton se kontrata ka për objekt ofrimin e shërbimeve dhe jo furnizimin me produkte biocide, mirëpo ky argument nuk e përjashton nevojën që produktet të cilat do të përdoren gjatë realizimit të kontratës të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme. Përkundrazi, duke qenë se vetë Autoriteti Kontraktues ka vendosur si kriter që produktet duhet të jenë ekologjike, ai është i obliguar të kërkojë edhe një dëshmi objektive që e mbështet këtë pretendim.

Një deklaratë e nënshkruar nga operatori ekonomik përfaqëson vetëm një deklaram të njëanshëm dhe nuk garanton se produktet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës i përmbushin në të vërtetë karakteristikat e kërkuara. Për këtë arsye, kërkesa jonë për paraqitjen e **Lejes për importin e biocideve**, të lëshuar nga **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**, nuk ka për qëllim kufizimin e konkurrencës, por sigurimin e një dokumenti zyrtar që mundëson identifikimin dhe verifikimin e produkteve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës.

Për më tepër, Leja për importin e biocideve përbën një dokument zyrtar të lëshuar nga autoriteti kompetent pas verifikimit të dokumentacionit teknik të produktit. Gjatë procedurës së regjistrimit dhe miratimit të biocideve, produktet identifikohen nëpërmjet CAS Number (Chemical Abstracts Service Number), i cili është identifikuesi unik ndërkombëtar i çdo substance kimike. Nëpërmjet këtij identifikuesi,

autoriteti kompetent verifikon përbërësit aktivë të produktit, përbërjen kimike dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore dhe teknike, duke lejuar regjistrimin vetëm të produkteve që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Për këtë arsye, Leja për importin e biocideve përbën një dëshmi objektive dhe të verifikueshme për produktet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës, ndryshe nga një deklaratë e operatorit ekonomik, e cila nuk mundëson verifikim efektiv nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se një kërkesë e tillë do të favorizonte vetëm operatorët importues nuk qëndron. Edhe operatorët ekonomikë që furnizohen nga distributorë apo importues të autorizuar mund ta sigurojnë dokumentacionin përkatës për produktet që ofrojnë, pasi Leja për importin lidhet me produktin dhe përbërjen e tij, e jo ekskluzivisht me operatorin ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Për rrjedhojë, kërkesa jonë nuk kufizon konkurrencën, por garanton që Autoriteti Kontraktues të ketë mundësi të verifikojë në mënyrë objektive produktet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës.

Sipas **nenit 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë trajtim të barabartë, transparencë dhe zhvillimin e një procedure të drejtë të prokurimit. Po ashtu, **neni 51** kërkon që kriteret dhe dëshmitë e kërkuara të jenë objektive dhe të përshtatshme për vërtetimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret, një deklaratë e operatorit ekonomik nuk përbën provë objektive për të vërtetuar se produktet e ofruara janë ekologjike, ndërsa Leja për importin e biocideve siguron një bazë zyrtare dhe të verifikueshme për identifikimin e produkteve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Për këto arsye, konsiderojmë se përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk e rrëzon pretendimin tonë, pasi nuk garanton një mekanizëm objektiv për verifikimin e produkteve ekologjike, por mbështetet vetëm në deklarin e operatorit ekonomik. Një qasje e tillë nuk siguron transparencë, nuk mundëson verifikim efektiv dhe nuk garanton që produktet e përdorura gjatë realizimit të kontratës do të jenë ato që kërkohen nga Dosja e Tenderit.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që, përveç deklaratës së operatorit ekonomik, të kërkojë domosdoshmërisht edhe Lejen për importin e biocideve, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ky është dokumenti zyrtar përmes të cilit autoriteti kompetent verifikon dhe regjistron produktet biocide që lejohen të vendosen në treg dhe të përdoren në Republikën e Kosovës, duke kontrolluar përbërjen e tyre, substancat aktive dhe përputhshmërinë me standardet dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, të harmonizuara me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Për këtë arsye, vetëm Leja për importin e biocideve garanton që produktet e përdorura janë produkte të regjistruara, të kontrolluara dhe të miratuara nga autoriteti kompetent, duke siguruar mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit.

Pretendimi nr. 12 (sipas renditjes nr rendor ne dosjen e tenderit)

Pretendimi ynë në Kërkesën për Rishqyrtim:

Lidhur me kërkesën nr.11 të Dosjes së Tenderit,

Kërkesa 12. Paisjet e nevojshme për kryrjen e këtij projekti. 1. Një automizer Power Spray me gjatësi gypi minimumi 60

Dëshmia 12.Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj libezat kopje , Dud doganor për makinerit që nuk kan libreza . Nëse nuk ekziston dud doganor , OE duhet të

metra 2. Dy automatizera elektronik Multifunksional për dezinfektim hapësinor 3. Pesë ULV elektronike 4. Pesë makina spërkatëse 5. Katër fumigator 6. Tri automjete për bartjen e makinerive dhe personelit

sjell faturat e blerjes me dëshmi bankare. Nëse OE ka marrëveshje për shfrytëzim të paisjeve, duhet të ofrohet marrëveshja për shfrytëzim të paisjeve për këtë projekt, me dokumentacion si Libereza , dud doganor ose fatura të blerjes me dëshmi bankare.(AK ruan të drejtën e vizitës në teren për vërtetimin të paisjeve nëse është e nevojshme)

Arsyetimi: Lidhur me kërkesën nr.12

Pika 1 – Një Atomizer (Power Spray) me gjatësi të gypit minimum 60 metra

Kjo kërkesë është tepër specifike dhe kufizuese, pasi përcakton një karakteristikë teknike të veçantë, përkatësisht gjatësinë minimale të gypit prej 60 metrash, pa ndonjë arsyetim teknik. Gjatësia e gypit nuk ndikon në cilësinë e realizimit të shërbimit, pasi pajisja është e lëvizshme dhe operatori mund të afrohet në zonën ku kryhet trajtimi. Vendosija e një kufizimi minimal prej 60 metrash kufizon pa nevojë. Kërkohej që të hiqet kufizimi për gjatësinë minimale prej 60 metrash dhe të lejohet përdorimi i Power Spray me gjatësi të gypit sipas nevojës teknike, duke filluar nga 10 metra e më shumë, pa vendosur kufizime të panevojshme që cenojnë konkurrencën.

Pika 2 – Dy atomizerë elektronikë multifunksionalë për dezinfektim hapësinor

Përshkrimi i kësaj kërkesë nuk është i qartë dhe nuk përfaqëson terminologjinë teknike të përdorur në fushën e shërbimeve DDD. Shprehja "**atomizer elektronik multifunksional për dezinfektim hapësinor**" është tepër e gjerë dhe e paqartë, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe mundësuar që operatorët ekonomikë të ofrojnë pajisje të ndryshme me karakteristika të ndryshme teknike. Për realizimin e dezinfektimit hapësinor, terminologjia e saktë teknike është **gjenerator për dezinfektim hapësinor**, i cili është pajisja e dedikuar për këtë lloj trajtimi. Përdorimi i një përshkrimi të pasaktë krijon paqartësi në përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave dhe nuk është në përputhje me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Kërkohej që Autoriteti Kontraktues të ndryshojë pikën 2 të Kërkesës nr. 12, duke zëvendësuar termin "**Dy atomizerë elektronikë multifunksionalë për dezinfektim hapësinor**" me terminologjinë e saktë teknike "**Një (1) gjenerator për dezinfektim hapësinor**", pasi një pajisje e tillë është e mjaftueshme për realizimin e kontratës dhe shmang paqartësitë në interpretimin e kërkesës.

Pika 5 – Katër fumigatorë

Kërkesa për **katër (4) fumigatorë** është e tepruar dhe nuk pasqyron nevojat reale të kontratës. Bazuar në praktikën profesionale të shërbimeve DDD, fumigatorët përdoren kryesisht për trajtimin e **grupave septike, kanalizimeve dhe ujërave të zeza**, ndërsa përdorimi i tyre në ambiente të brendshme është shumë i kufizuar për shkak të rrezikut të kontaminimit dhe kërkesave të larta të sigurisë. Për rrjedhojë, kërkesa për katër fumigatorë nuk është proporcionale me objektin e kontratës dhe krijon kufizime të panevojshme. Kërkohej që pika 5 e Kërkesës nr. 12 të hiqet nga Dosja e Tenderit ose, nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron të domosdoshme, numri i fumigatorëve të zvogëlohet nga katër (4) në dy (2), në përputhje me nevojat reale të kontratës.

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues Pretendimi/kerkesa (12):

PËRGJIGJE NDAJ KËRKESËS PËR RISHQYRTIM: KERKESA (12)

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin e Operatorit Ekonomik se kërkesa për pajisje teknike profesionale – automizer power spray me gjatësi minimale të gypit 60 metra – është kërkesë joproporcionale apo kufizuese e konkurrencës.

Kjo kërkesë është përcaktuar duke u bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat praktike të shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit (DDD), ku efikasiteti i trajtimit, siguria e operatorëve, qasja në zona të vështira dhe mbulimi i sipërfaqeve të mëdha janë elemente thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Fakti që pajisja është e lëvizshme nuk e eliminon nevojën për një gjatësi adekuate të gypit të spërkatjes. Lëvizshmëria e pajisjes nënkupton mundësinë e transportimit të saj nga një lokacion në tjetrin, por nuk e zëvendëson funksionalitetin teknik të saj gjatë operimit. Në praktikë, gjatë kryerjes së shërbimeve DDD, ekzistojnë ambiente ku zhvendosja e vazhdueshme e pajisjes është e pamundur, joefikase ose krijon pengesa operative, siç janë objektet e mëdha, institucionet publike, depot, bodrumet, hapësirat sanitare dhe zona të tjera ku kërkohet trajtim i vazhdueshëm dhe uniform.

Kërkesa për gyp me gjatësi minimale 60 metra nuk është përcaktuar si kriter formal për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, por si kërkesë minimale teknike për të siguruar që pajisja të ketë kapacitetin e nevojshëm për kryerjen profesionale dhe efikase të shërbimeve të kërkuara. Një gjatësi prej vetëm 10 metrash, siç propozohet nga Operatori Ekonomik, mund të jetë e pamjaftueshme në shumë situata operative dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë, kohën e realizimit dhe sigurinë gjatë punës.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar gjithashtu parimin e proporcionalitetit dhe të zgjerimit të konkurrencës, pasi nuk ka kërkuar domosdoshmërisht që pajisja të jetë në pronësi të Operatorit Ekonomik. Në dokumentet e tenderit është lejuar shprehimisht edhe mundësia e sigurimit të pajisjes përmes marrëveshjes për shfrytëzim për këtë aktivitet të prokurimit, duke u dhënë mundësi operatorëve ekonomikë që nuk e posedojnë pajisjen në pronësi ta sigurojnë atë për realizimin e kontratës.

Rrjedhimisht, kërkesa e Autoritetit Kontraktues është një kërkesë funksionale dhe teknike, e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me nevojën për garantimin e një shërbimi cilësor, profesional dhe të sigurt. Ajo nuk paraqet kufizim të padrejtë të konkurrencës, por një standard minimal teknik që duhet të përmbushet nga operatorët ekonomikë që synojnë realizimin e këtyre shërbimeve në mënyrë efektive. Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin e Operatorit Ekonomik për ndryshimin e kërkesës teknike nga “automizer elektronik multifunksional për dezinfektim hapësinor” në “gjenerator për dezinfektim hapësinor”, si dhe për reduktimin e numrit të pajisjeve nga dy (2) në një (1).

Kërkesa e përcaktuar në dokumentet e tenderit është bazuar në nevojat reale operative të Autoritetit Kontraktues dhe në kompleksitetin e shërbimeve të dezinfektimit që duhet të realizohen. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristikat minimale teknike që konsiderohen si të nevojshme për realizimin efikas, cilësor dhe në kohë të kontratës.

Pretendimi se një pajisje është e mjaftueshme nuk mund të jetë bazë për ndryshimin e kërkesës, pasi përcaktimi i kapacitetit minimal teknik është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues. Kërkesa për dy (2) automizer elektronik multifunksional është vendosur për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve, mbulimin e nevojave operative dhe shmangien e vonësive në rast të trajtimeve të njëkohshme, volumit të shtuar të punës apo problemeve teknike me njërin pajisje si dhe

mbulimin e hapësirave për shërbime të Dezinfektimit hapësiror në të njëjtën kohë ,në disa vende të ndryshme prandaj edhe ne si AK kemi kërkuar dy pajisje të tilla që janë cekur më lartë e që kanë këto mjete të punës kanë disa funksione në të njëjtën kohë.Gjithashtu, kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, pasi Autoriteti Kontraktues ka lejuar që pajisjet të sigurohen edhe përmes marrëveshjes për shfrytëzim dhe jo vetëm përmes pronësisë.

Sa i përket ndryshimit të termit nga “automizer elektronik multifunksional” në “gjenerator”, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa është përcaktuar sipas funksionit dhe performancës së nevojshme të pajisjes dhe nuk mund të ndryshohet nëse kjo cenon standardin teknik të kërkuar.pasi që paisja e tillë kryen funksione multifunksionale nga e njëjta paisje.

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin e Operatorit Ekonomik për ndryshimin e kërkesës teknike nga “automizer elektronik multifunksional për dezinfektim hapësiror” në “gjenerator për dezinfektim hapësiror”, si dhe për reduktimin e numrit të pajisjeve nga dy (2) në një (1).

Kërkesa e përcaktuar në dokumentet e tenderit është bazuar në nevojat reale operative të Autoritetit Kontraktues dhe në kompleksitetin e shërbimeve të dezinfektimit që duhet të realizohen. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristikat minimale teknike që konsiderohen të nevojshme për realizimin efikas, cilësor dhe në kohë të kontratës.

Pretendimi se një pajisje është e mjaftueshme nuk mund të jetë bazë për ndryshimin e kërkesës, pasi përcaktimi i kapacitetit minimal teknik është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues. Kërkesa për dy (2) automizer elektronik multifunksional është vendosur për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve, mbulimin e nevojave operative dhe shmangien e vonësive në rast të trajtimeve të njëkohshme, volumit të shtuar të punës apo problemeve teknike me njërin pajisje.

Gjithashtu, kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, pasi Autoriteti Kontraktues ka lejuar që pajisjet të sigurohen edhe përmes marrëveshjes për shfrytëzim dhe jo vetëm përmes pronësisë.

Sa i përket ndryshimit të termit nga “automizer elektronik multifunksional” në “gjenerator”, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa është përcaktuar sipas funksionit dhe performancës së nevojshme të pajisjes dhe nuk mund të ndryshohet nëse kjo cenon standardin teknik të kërkuar.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues mbetet pranë kërkesës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, pasi ajo është proporcionale, e arsyeshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me qëllimin e kontratës – sigurimin e shërbimeve profesionale dhe efikase të dezinfektimit hapësiror.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMIN NR. 12

Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar pretendimet tona lidhur me Kërkesën nr. 12 të Dosjes së Tenderit. Nga përgjigjja e tij rezulton se:

- **Pika 1 – Power Spray me gyp minimum 60 metra** → është refuzuar.
- **Pika 2 – Ndryshimi i terminologjisë nga "atomizer elektronik multifunksional" në "gjenerator për dezinfektim hapësiror"** → është refuzuar.
- **Pika 2 – Zvogëlimi i numrit të pajisjeve nga dy (2) në një (1)** → është refuzuar.
- **Pika 5 – Katër (4) fumigatorë** → nuk është shqyrtuar dhe nuk është dhënë asnjë përgjigje.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë një arsyetim të plotë dhe nuk i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Lidhur me Pikën 1 – Power Spray me gyp minimum 60 metra

Autoriteti Kontraktues pretendon se gjatësia minimale prej 60 metrash është e nevojshme për realizimin e kontratës, mirëpo nuk paraqet asnjë analizë teknike, profesionale apo funksionale që justifikon pikërisht këtë gjatësi.

Në asnjë pjesë të përgjigjes nuk sqarohet pse është i domosdoshëm një gyp **minimum 60 metra**, dhe jo 20, 30 apo 40 metra. Autoriteti Kontraktues është mjaftuar vetëm me përsëritjen e përgjithshëm të mënyrës së përdorimit të pajisjes, pa argumentuar lidhjen ndërmjet gjatësisë prej 60 metrash dhe cilësisë së realizimit të kontratës.

Për më tepër, **Power Spray** është pajisje e lëvizshme dhe operatori mund ta afrojë atë në vendin ku kryhet trajtimi. Për këtë arsye, gjatësia e gypit nuk përbën element vendimtar për

realizimin e shërbimit. Vendosija e një karakteristike kaq specifike, pa ndonjë bazë objektive, kufizon në mënyrë të panevojshme operatorët ekonomikë dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në nenet 7, 51 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Lidhur me Pikën 2 – "Atomizer elektronik multifunksional"

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues se termi **"atomizer elektronik multifunksional për dezinfektim hapësinor"** është i mjaftueshëm.

Ky nuk është term teknik i standardizuar në fushën e DDD-së, por një përshkrim i përgjithshëm që krijon paqartësi gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave. Mjafton një kërkim i thjeshtë në internet për të konstatuar se me termin **"atomizer elektronik multifunksional"** paraqiten dhjetëra pajisje të ndryshme, me karakteristika, funksione dhe qëllime të ndryshme përdorimi. Një përshkrim i tillë nuk identifikon qartë pajisjen që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme nga operatorët ekonomikë.

Nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues është realizimi i **dezinfektimit hapësinor**, atëherë terminologjia teknike e saktë është **"Gjenerator ULV për dezinfektim hapësinor"**, pasi kjo është pajisja profesionale e dedikuar për këtë lloj trajtimi. Përdorimi i një terminologjie të pasaktë cenon parimin e transparencës dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për **dy (2) pajisje**. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike apo operative që dëshmon se një pajisje nuk është e mjaftueshme për realizimin e kontratës.

Vetë Dosja e Tenderit parasheh që dezinfektimi hapësinor do të realizohet në një sipërfaqe prej **392 hektarësh në vit**, sipërfaqe e cila mund të mbulohet pa vështirësi me një **Gjenerator ULV profesional**, duke marrë parasysh kapacitetin dhe performancën e këtyre pajisjeve. Për këtë arsye, kërkesa për dy pajisje është joproporcionale dhe nuk është mbështetur me asnjë analizë objektive që dëshmon domosdoshmërinë e saj.

Lidhur me Pikën 5 – Katër fumigatorë

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë **asnjë përgjigje**, ndonëse ne kemi kërkuar heqjen ose zvogëlimin e numrit të fumigatorëve.

Në praktikën profesionale të shërbimeve DDD, fumigatorët nuk janë pajisje që përdoren në mënyrë të vazhdueshme në çdo kontratë. Ato përdoren vetëm në raste të veçanta, kryesisht për trajtimin e kanalizimeve, gropave septike dhe ambienteve specifike ku kërkohet aplikimi i tymit ose gazit. Për shumicën dërrmuese të shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit, fumigatorët nuk përbëjnë pajisje bazë operative.

Për këtë arsye, kërkesa për **katër (4) fumigatorë** është e pajustificuar, nuk pasqyron nevojat reale të kontratës dhe vendos një barrë të panevojshme financiare mbi operatorët ekonomikë. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike, plan operativ apo arsyetim profesional që dëshmon se për realizimin e kësaj kontrate janë të domosdoshëm katër fumigatorë. Mungesa e plotë e përgjigjes për këtë pretendim tregon se Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar fare këtë pjesë të Kërkesës për Rishqyrtim.

Sipas **nenit 7**, si dhe **neneve 51 dhe 69** të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të vendosë kërkesa teknike proporcionale, objektive dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pa kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Në rastin konkret, asnjë nga kërkesat e kontestuara nuk është arsyetuar me analiza teknike apo profesionale, ndërsa për një pjesë të pretendimeve nuk është dhënë fare përgjigje.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë pretendim ankimor, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues në këtë pjesë dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që ta rishikojë Kërkesën nr. 12 të Dosjes së Tenderit, si në vijim:

- Lidhur me pikën 1, të largohet kërkesa për Power Spray me gjatësi minimale të gypit prej 60 metrash, pasi nuk është arsyetuar teknikisht pse kërkohet pikërisht kjo gjatësi minimale dhe jo një gjatësi tjetër që përmbush nevojat e realizimit të kontratës.

- Lidhur me pikën 2, të zëvendësohet termi "atomizer elektronik multifunksional për dezinfektim hapësinor" me terminologjinë e saktë teknike "Gjenerator ULV për dezinfektim hapësinor", si dhe të zvogëlohet numri i pajisjeve nga dy (2) në një (1), pasi një pajisje e tillë është e mjaftueshme për realizimin e dezinfektimit hapësinor në sipërfaqen prej 392 hektarësh të paraparë me këtë kontratë.

- Lidhur me pikën 5, të hiqet kërkesa për katër (4) fumigatorë ose, nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron të domosdoshme, numri i tyre të zvogëlohet në dy (2), pasi nuk është paraqitur asnjë analizë teknike apo operative që arsyeton nevojën për katër pajisje të tilla.

Këto ndryshime janë të nevojshme që kërkesat teknike të jenë proporcionale, objektive dhe në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Mospërputhja e kriterëve të procedurës aktuale me praktikën e mëparshme të Autoritetit Kontraktues

Përveç pretendimeve të paraqitura më sipër, konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë se kriteret e përcaktuara në procedurën aktuale të prokurimit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga kriteret që i njëjti Autoritet Kontraktues ka aplikuar në procedurat e mëparshme për të njëjtin objekt kontrate, përkatësisht për shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD).

Nga krahasimi i Dosjes së Tenderit me nr. të prokurimit 617-21-4500-2-2-1, datë 02.08.2021, Dosjes së Tenderit me nr. të prokurimit 617-21-4500-2-2-1, datë 23.05.2024, si dhe Dosjes së Tenderit me nr. të prokurimit 617-25-3602-2-2-1, datë 19.05.2025, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Agronomin si pjesë të stafit profesional, ka kërkuar Lejen për importimin e produkteve biocide si dokument të detyrueshëm për verifikimin e produkteve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës dhe ka përdorur terminologjinë teknike "Gjenerator ULV" për pajisjet e dezinfektimit hapësinor.

Ndërsa në procedurën aktuale, pa paraqitur ndonjë arsyetim teknik, profesional apo ligjor, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar këto kriterë, duke përjashtuar profile profesionale që më parë i ka konsideruar të pranueshme, duke mos e kërkuar më Lejen për importimin e produkteve biocide si dëshmi objektive dhe duke përdorur terminologji të ndryshme për pajisjet teknike.

Në përgjigjet ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë shpjegim se cilat janë arsyet objektive që kanë imponuar këto ndryshime, çfarë ka ndryshuar në natyrën e kontratës, në mënyrën e realizimit të shërbimeve apo në legjislacionin në fuqi, që do të justifikonte largimin nga praktika e tij e deritanishme.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë të tregut, analizë teknike, analizë profesionale apo ndonjë dokument tjetër që do të dëshmonte se ndryshimet e bëra në kriteret e procedurës aktuale kanë qenë të domosdoshme dhe proporcionale për realizimin e kontratës. Përkundrazi, kriteret janë ndryshuar pa u mbështetur në ndonjë bazë objektive, edhe pse objekti i kontratës mbetet i njëjtë me procedurat e mëparshme.

Në mungesë të një arsyetimi të tillë, këto ndryshime krijojnë dyshime të bazuara se kriteret nuk janë përcaktuar vetëm mbi nevojat reale të kontratës, por mund të kenë efekt kufizues mbi konkurrencën dhe të favorizojnë operatorë ekonomikë të caktuar, në kundërshtim me parimet e barazisë, proporcionalitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit, të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit** që, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, të marrë në konsideratë edhe praktikën e mëparshme të vetë Autoritetit Kontraktues, e cila dëshmon se kriteret e kontestuara në procedurën aktuale përfaqësojnë një devijim të pajustificuar nga praktika e deritanishme, pa ndonjë bazë objektive, teknike apo ligjore.

Ky pretendim mbështetet në dokumentet e Dosjeve të Tenderit të procedurave të prokurimit të viteve 2021, 2024 dhe 2025, të cilat i bashkëngjiten kësaj ankese si prova.

Provat e bashkëngjitura

- **Prova nr. 1** – Dosja e Tenderit me nr. të prokurimit **617-21-4500-2-2-1**, datë **02.08.2021**, për **Kontratë Kornizë me kohëzgjatje 24 (njëzet e katër) muaj**.
- **Prova nr. 2** – Dosja e Tenderit me nr. të prokurimit **617-21-4500-2-2-1**, datë **23.05.2024**.
- **Prova nr. 3** – Dosja e Tenderit me nr. të prokurimit **617-25-3602-2-2-1**, datë **19.05.2025**.

Përfundim

Si përfundim, nga provat e bashkëngjitura rezulton qartë se i njëjti Autoritet Kontraktues, në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë viteve 2021, 2024 dhe 2025, për të njëjtin objekt kontrate – shërbimet e DDD-së – ka aplikuar kriteret e ndryshme nga ato të procedurës aktuale. Veçanërisht, në procedurën e vitit 2021, e cila ishte Kontratë Kornizë me kohëzgjatje 24 muaj, Autoriteti Kontraktues kishte përcaktuar kriteret që i konsideronte të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Edhe në procedurat e viteve 2024 dhe 2025 janë përdorur kriteret e njëjta ose të ngjashme, duke kërkuar ndër të tjera Agronomin si pjesë të stafit profesional, Lejen për importimin e produkteve biocide dhe terminologjinë teknike "Gjenerator ULV" për pajisjet e dezinfektimit hapësinor. Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues është larguar nga kjo praktikë pa paraqitur asnjë analizë të tregut, analizë teknike, profesionale apo ligjore që do të arsyetonte këto ndryshime. Për më tepër, edhe në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim nuk është dhënë ndonjë arsyetim objektiv që justifikon devijimin nga praktika e deritanishme. Për këtë arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, t'i marrë në konsideratë provat e bashkëngjitura dhe të konstatojë se kriteret e kontestuara janë vendosur pa një bazë objektive dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së lirë, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në të gjitha argumentet faktike, ligjore dhe provat e bashkëngjitura kësaj ankese, lusim Ekspertin Shqyrtues që gjatë hartimit të mendimit profesional dhe Panelin e Organit Shqyrtues të Prokurimit gjatë vendimmarrjes, t'i shqyrtojnë me kujdes të gjitha pretendimet tona, t'i vlerësojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme provat e paraqitura, si dhe të marrin një vendim të bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe faktet e konstatuara në këtë procedurë. Jemi të bindur se një vlerësim i drejtë dhe i paanshëm i kësaj çështjeje do të çojë në konstatimin se kriteret e kontestuara nuk janë vendosur në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së lirë, duke bërë të nevojshme aprovimin e pretendimeve tona ankimore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e pretenduara kanë ndikuar negativisht në reputacionin dhe imazhin profesional të kompanisë sonë, duke pasur parasysh veprimtarinë tonë shumëvjeçare në fushën e shërbimeve DDD. Përveç dëmtimit të reputacionit, këto veprime i kanë shkaktuar kompanisë sonë edhe dëm material dhe financiar, si pasojë e shpenzimeve të bëra për përgatitjen e ofertës, sigurimin e dokumentacionit dhe pjesëmarrjen në këtë procedurë të prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*